



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilbena / Prilbena Received / Delivery	04.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojci * Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTKK	1179/2022		116



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.74/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.74/2022 të datës 28.01.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat \_\_\_\_\_ me adresë rruga \_\_\_\_\_ kundër Vendimit me Nr. Ref:05/2022 të datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.74/2022 të datës 28.01.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Ref:05/2022 i datës 11.01.2022 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

### A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, fillimisht sipas kontratës së marrëdhënies të punës së datës 10.06.2009 ka qenë në pozitën "Zyrtar i Lartë për Politikën e Zgjerimit të BE-së", të cilit më datë 05.09.2012 i është lëshuar Akt Emërimi nr.002 për të njëjtën pozitë pa afat.



Më datë 30.04.2014 sipas Vendimit me Nr. Ref:287/2014 ankuesit i miratohet grada diplomatike Sekretar i Dytë dhe është caktuar të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Budapest të Hungarisë. Më datë 30.12.2015 sipas Vendimit me Nr. Ref:129/2015 ngritet në detyrë dhe është caktuar si Sekretar i Parë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Budapest të Hungarisë. Më datë 15.12.2016 përmes Vendimit me Nr. Ref:763/2016 ankuesi është transferuar paralelisht në të njëjtën gradë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë të Republikës Çeke. Sipas Vendimit me Nr. 330/2020 të datës 10.07.2020 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme ankuesi tërhiqet nga misioni diplomatik, duke e obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të bëhet sistemimi i ankuesit. Me Vendimin me Nr.119/2020 të datës 01.09.2020 ankuesi sistemohet përkohësisht në pozitën Zyrtar i Lartë për Parlamentin Evropian dhe Vendet jo anëtare të BE-së, ndërsa me datë sipas vendimit me Nr.115/2020 të datës 01.09.2020 ankuesi sistemohet në pozitë të përhershme Zyrtar i Lartë për Parlamentin Evropian dhe Vendet jo anëtare të BE-së,

ndërsa me Vendimin me Nr. Ref:206/2020 të datës 18.11.2020 të zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është caktuar zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit për BE dhe Evropë, ndërsa me Vendimin Nr. 231/2020 të datës 09.12.2020 të zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ankuesi sistemohet në pozitën Udhëheqës i Departamentit për BE dhe Evropë, ndërsa më Vendimin me Nr. Ref:1028/2020 të datës 18.12.2020 të Ministres së Ministrisë së punëve të Jashtme dhe Diasporës është caktuar zv. Drejtor i Përgjithshëm në MPJD.

Më datë 19.02.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka lëshuar Akt Emërim AE.Nr.17/2021 më të cilin ankuesin e ka emëruar në pozitën Udhëheqës i Departamentit për BE dhe Evropë.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 11.01.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref:05/2022 me të cilin ka bërë shfuqizimin e Vendimit me Nr. Ref:231/2020 të datës 09.12.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Akt Emërimin me Nr. 17/2021 të datës 19.02.2021, duke sistemuar ankuesin në pozitën e Zyrtar i Lartë për Parlamentin Evropian dhe Vendet jo anëtare të BE-së.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Ref:05/2022 të datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, fizikisht përmes përfaqësuesit të tij, më datë 28.01.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:394/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Më datë 11.02.2022 Këshilli ka pranuar



përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr. Prot:394/2022 të datës 28.01.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 25.01.2022; Emailin e datës 10.01.2022, 18.01.2022, 21.01.2022 dhe 24.01.2022 nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm MPJ; Vendimin me Nr. Ref:05/2022 të datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt Emërim AE.Nr.17/2021 i datës 19.02.2021 në emër të ankuesit; Vendimin me Nr. Ref:1028/2021 i datës 18.12.2020 i Ministres së MPJD-së; Vendimin me Nr. Ref:231/2021 i datës 09.12.2020 i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin me Nr.206/2020 i datës 18.11.2020 i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin me Nr. Ref:4115/2020 i datës 01.09.2020 të Ministrisë së MPJD-së; Vendimin me Nr. 330/2020 i datës 10.07.2020 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr.Ref:763/2016 i datës 16.12.2016 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr. Ref:129/2015 i datës 30.12.2015 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 10.06.2011, 10.06.2009; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 02.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 11.02.2022; Akt Emërimin e datës 06.12.2012 në emër të ankuesit; Raportin final të auditimit "menaxhimi i burimeve njerëzore" i datës 03.11.2021; Shkresë me titull "Një shërbim, një Ministri".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që Vendimi me Nr. Ref:05/2022 i datës 11.01.2022 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk janë zbatuar dispozitat ligjore speciale për sistemim, transferim dhe gradim të diplomatëve të karrierës në shërbimin e jashtëm dhe ministri; Lëvizjet e stafit nga shërbimi civil në shërbimin diplomatik dhe anasjelltas janë bërë sipas diskrecionit ligjor që ka pasur ministri i MPJ sipas nenit 21 dhe 23 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës; Meqë nuk ka dispozita të veçanta që rregullojnë transferimin respektivisht sistemimin e diplomatëve që kthehen nga shërbimi duhet të vlejnjë dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 4 paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë"*, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar që: *"Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve"*, mbi bazë të kësaj Kolegji për



Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se sipas Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i është njohur e drejta që me rregulla veçanta të rregulloj mënyrën e transferimit dhe sistemimit të nëpunësve civil, mirëpo gjatë shqyrtimit të legjislacionit përkatës i cili rregullon fushëveprimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, konstaton se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka rregulla të veçanta të transferimit apo të sistemimit respektivisht lëvizjes së stafit nga shërbimi civil në shërbimin diplomatik dhe anasjelltas.

Meqenëse nuk ka rregulla të veçanta për çështjet që i ka rregulluar neni 4 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, atëherë deri në rregullimin e kësaj çështje, të zbatueshme janë dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, konstaton që ankuesi para caktimit që të shërbej në misionet diplomatike në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Budapest të Hungarisë respektivisht në Pragë të Republikës Çeke, ka mbajtur pozitën "Zyrtar i Lartë për Politikën e Zgjerimit të BE-së" sipas Akt Emërimit me afat të pacaktuar, ndërsa pas kthimit respektivisht tërheqjes nga misioni diplomatik të ankuesit, i njëjti është sistemuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Parlamentin Evropian dhe vendet jo anëtarë të BE-së sipas Vendimit me Nr.115/2020 të datës 01.09.2020, mirëpo sipas Vendimit Nr. 231/2020 të datës 09.12.2020 të zv.Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ankuesi sistemohet në pozitën Udhëheqës i Departamentit për BE dhe Evropë dhe bazuar në këtë vendim Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 19.02.2021 ka lëshuar Akt Emërim AE.Nr.17/2021 më të cilin ankuesin e ka emëruar në pozitën Udhëheqës i Departamentit për BE dhe Evropë.

Lidhur me sistemimin e përhershëm të ankuesit në pozitën Udhëheqësi i Departamentit për BE dhe Evropë sipas Vendimit me Nr. 231/2020 të datës 09.12.2020, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që pas kthimit nga misioni diplomatik ankuesi është sistemuar në pozitë jo ekuivalente me pozitën që ka mbajtur sipas Akt Emërimit me afat të pacaktuar të datës 06.12.2012, ndërsa në asnjë dispozitë ligjore nuk është e lejuar që të nëpunësit civil të sistemohen në mënyrë të përhershme në një pozitë me gradë më të lartë dhe pozitë udhëheqëse, ndërsa në rastin konkret të ankuesit i njëjti është ngritur në detyrë nga pozita Zyrtar i Lartë për Parlamentin Evropian dhe vendet jo anëtarë të BE-së në pozitën Udhëheqësi i Departamentit për BE dhe Evropë, vetëm me vendim, si rrjedhojë me asnjë normë ligjore nuk është rregulluar që në bazë të diskrecionit nëpunësit civil të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pas kthimit nga misioni diplomatik të sistemohen në çfarëdo pozite që është e lirë çoftë ajo edhe në gradë më të lartë.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 39 paragrafi 3, ka përcaktuar se: *"Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë"*, kurse neni 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të*



*pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore”.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar këtyre dispozitave, konstaton se Vendimi me Nr. Ref:231/2020 i datës 09.12.2020 i nxjerr nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për sistemimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Departamentit për BE dhe Evropë, është nxjerr në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1, nenin 39 paragrafi 3 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ankuesi me këtë vendim është ngritur në detyrë pa asnjë procedurë ligjore, rrjedhimisht edhe Akt Emërimi AE.Nr.17/2021 i datës 19.02.2021 është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil.

Po ashtu lidhur me Vendimin me Nr. Ref:05/2022 të datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me të cilin është shfuqizuar Vendimi me Nr. Ref:231/2020 i datës 09.12.2020 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Akt Emërimi me Nr.17/2021 të datës 19.02.2021, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me nenin 53 paragrafi 1 dhe nenin 55 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, andaj bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara në legjislacionin në fuqi të shërbimit civil.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.74/2022, datë 04.03.2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMShCK-së

